

THE WOMEN'S TRADICIONAL COSTUMES AT MALI I THATË VESHJET TRADICIONALE E GRAVE TË MALIT TË THATË

HIRIET ZIBERI¹, D. SEIWERT²

¹Fakulteti Filozofik, Universiteti Shtetëror i Tetovës

²ZEOK e.V. Leipzig, Gjermani

hiriet.ziberi@unite.edu.mk

AKTET V, 4: 646-650, 2012

PERMBLEDHJE

Veshja i takon pjesës së kulturës materiale që pasqyron shumë realitete dhe funksione (1). Veshja është simbol për diferencimin ekonomik, social dhe kulturor, si dhe simbol i përkatësisë regjionale dhe etnike të një popullate. Në vazhden e ruajtjes së kulturës materiale janë bërë hulumtime në terren mbi veshjen tradicionale në zonën e Malit të Thatë në Republikën e Maqedonisë. Janë mbledhur materiale të shumëllojshme dhe janë kryer intervista të shumta me banorët e kësaj ane, me qëllim të sqarimit të pjesëve përbërëse të veshjeve, përshkrimin e tyre, qëllim për të cilin janë veshur etj. Gjithashtu është vjelur material edhe mbi klasifikimin e veshjeve sipas grup moshave, rasteve, gjendjes ekonomike si dhe statutit në shoqëri. Në këto rajone veshja tradicionale është ruajtur me shumë devotshmëri në shekuj, por zhvillimi shoqëroro-ekonomik ka bërë që, në vitet e fundit, çdo ditë e më shumë të dalin nga përdorimi. Janë kryesisht gjeneratat më të vjetra të këtyre fshatrave që, edhe sot e kësaj dite, i ruajnë veshjet tradicionale me përkushtim të madh. Në fshatrat e Malit të Thatë si: Korita, Gurgurnica dhe Sallareva, veshjet e grave ende përdoren në raste festimesh të ndryshme dhe dasmash, edhe pse jo si më parë. Në veshjet e femrave dominojnë motive të ndryshme zbukurimi. Veshjet tradicionale shqiptare janë të shumëllojshme, me elemente të ndryshme, nga të cilat disa e kanë zanafillën që nga koha e vjetër, nga kultura ilire. Ndërsa sot disa nga motivet dhe zbukurimet janë të kohës së sotme dhe pak kanë të bëjnë me të kaluarën historike të popullit tonë. Me këtë punim është shprehur dëshira dhe gatishmëria për të hulumtuar dhe përshkruar veshjen e gruas në vendbanimet e Malit të Thatë, si një ndër veshjet më karakteristike të trevave shqiptare në Maqedoni me shpresën se nuk do të zhduken në tërësi.

Fjalët kyçe: Kultura materiale, Veshja tradicionale, Mali i Thatë

Key words: Material cvulture, tradicional costumes, Mali i Thatë

1. HYRJA

Veshja është pjesë e përditshmërisë sonë, me anë të së cilës tregohen dhe përfaqësohen veti dhe tipare të ndryshme të njeriut si individ dhe të shoqërisë në përgjithësi. Veshjet tradicionale, të ruajtura me shekuj, kanë shërbyer për të dalluar etnitë apo grupet e ndryshme nga njëra – tjetra, si dhe për të ruajtur identitetin e tyre. Në këtë punim paraqiten veshjet tradicionale të malit të thatë si në fshatrat Koritë, Gurgurnicë, Sallarevë. Ky punim u realizua duke kryer hulumtime në terren, me anë të mbledhjes së materialeve të

ndryshme origjinale dhe me anë të intervistimit të personave të caktuar të këtyre fshatrave, veçanërisht atyre pak njerëzve që edhe sot e kësaj dite i bartin ato veshje me devotshmëri. Duhet theksuar se këto zona janë shumë pak të hulumtuara dhe mungon një sistematizim i të mirave materiale. Pikërisht kjo ishte arsyeja që të merrem me këtë tematikë, sepse zhvillimet shoqërore të ditëve të sotme bëjnë që kjo trashëgimi materiale të zhduket për një kohë të shkurtër. Prandaj edhe mbledhja dhe sistemimi i

tyre është i patjetërsueshëm nëse dëshirojmë ta ruajmë kulturën dhe traditën tonë.

2. Territoret e Malit të Thatë

Mali i Thatë është një rajon malor, që shtrihet në veriperëndim të Maqedonisë. Këtu bëjnë pjesë tri fshatra, edhe atë Korita, Gurgurnica dhe Sallareva. Këto fshatra shtrihen në një lartësi mbidetare prej 800 m deri më 1200 m. Struktura e popullatës së këtyre fshatrave ndryshon dukshëm. Përderisa në fshatin Koritë kemi një dyndje të madhe të popullatës në zonat më të ulëta, fshatrat Sallarevë dhe Gurgurnicë kanë arritur të ruajnë numrin e banorëve.

3. Veshja e Malit të Thatë

Këto fshatra si shumica e fshatrave shqiptare kanë një veshje tradicionale, karakteristike të kësaj zone, e cila është trashëguar dhe ruajtur me gjenerata të tëra. Kjo veshje edhe pse sot përdoret shumë pak, megjithatë ka arritur të mbijetojë deri në ditët e sotme. Veshja e këtij regjioni i takon pjesës së kulturës materiale që pasqyron shumë realitete dhe funksione. Veshja është simbol për diferencimin ekonomik, social dhe kulturor, si dhe simbol i përkatësisë rajonale dhe etnike të kësaj popullate.

Veshja e Malit të Thatë është përgatitur, zbukuruar dhe ruajtur me shumë përkushtim, ajo edhe sot ruhet me shumë përkujdesje. Për dallim nga veshja e burrave që ka qenë më e thjeshtë, veshja e grave është më e ndërlikuar. Për veshjen e tyre, varësisht prej llojit dhe kategorisë së njerëzve që e kanë bartur, shpeshherë është nevojitur ndihma e një personi të dytë, pasi që ata kishin një radhitje, e cila duhej të njihej mirë.

4. Veshja e grave

Veshja e grave përbëhet me mbi 20 pjesë dhe këto do të jenë (sipas radhitjes së veshjes): brekët, këmisha, litari i këmishës dhe anterisë, xhybeli, anteria, brezi, poshi, bofçarka, rizat, sharpat (shamijat), sharpa e përpunuar, kollani, gjerdanet, tasi, korpa, hajmalia, unazat, çulkat, kalçinjët dhe xhari ose tërliku.

Pjesët e sipërpërmendura janë përdorur në sasi dhe forma të ndryshme varësisht nga kategoria

dhe mosha e bartëses. Kështu nusët kanë veshur të gjitha pjesët e përmendura më sipër. Nusët e reja kanë poseduar deri në pesë anteri dhe, në shumicën e rasteve, nga dhjetë këmisha dhe gjashtë deri në dhjetë bofçarka.

Pjesët më të zakonshme të veshjeve tradicionale që i kanë bartur dhe që pjesërisht i veshin edhe në ditët e sotme janë: këmisha, anteria, brezi, bofçarka, çorapët, çulkat dhe tërliku.



Fig. 1. Këmisha me Kinda

(1) Këmisha (fig.1) është pjesa kryesore tek të gjitha moshat, e cila, më herët, zakonisht prodhohej prej materialit të përpunuar vetë, ndërsa në dy dekadat e fundit blihet e gatshme. Ekzistojnë dy lloje këmishash, e hollë (e mirë) dhe këmisha e trashë (e dorës së dytë ose këmishë shtëpiake, pasi që është veshur çdoherë nëpër shtëpi).

Varësisht nga gjendja ekonomike, shtresat më të ulta përgatitnin për martesë nga 4 ose 5 këmisha, ndërsa shtresat më të larta 20 deri 25 këmisha (4). Më herët këmishat ishin të gjata deri tek kyçi i këmbës, por me kohën ajo është shkurtuar vazhdimisht midis 30 dhe 40 cm, me idenë se ajo duket më bukur, kur është më e shkurtër.

Rol të rëndësishëm në përgatitjen e këmishës kanë *kindat* (falltat) dhe krahët. Ka dy lloje të *kindave*, të vogla dhe të mëdha. Këmisha me Kinda mund të ketë një gjerësi prej 2-10 m, por shumica ishin me një gjerësi prej 4,5 m. Numri mesatar i kindave ishte 15-20, ndërsa mund të arrinte deri në 90 kinda. Qëllimi kryesor i pasjes së shumë kindave ishte aspekti estetik, pra i zbukurimit, p.sh. gratë e dobëta vishnin çdoherë nga dy ose tri këmisha.

Krahët e këmishës janë të ngushtë dhe të gjatë, për arsye se gratë nuk kishin stoli dore (5). Zbukurimi i këmishës, në kohët më të hershme, bëhej vetëm rreth prerjes së jakës e cila ka formën (e shkronjës) V dhe rrethit të mëngëve, por në dhjetëvjeçarët e fundit vërehen zbukurime edhe në pjesët e përparme të gjoksit, si dhe prehri i këmishës (7).



Fig. 2. Xhybeli

(2) Mbi këmishë vishet **xhybeli** (fig. 2), i cili është një jelek i përbërë prej dy materialeve. Pjesa e përparme është prej materiali të kadifesë së kuqe të errët e qëndisur me serm (fije argjendi ose ari) dhe gajtan. Zbukurimi i jelekut bëhet sipas dëshirës personale dhe zakonisht blihen. Xhybeli vishet më së shumti nga gratë e reja dhe me të gjitha anteritë.

(3) Siç përmendëm dhe më lartë shumica e grave kanë poseduar nga pesë **anteri** (fig. 3), por gjithsej ishin shtatë: anteria e mirë, arna e zezë, sharovkë, çilorgovan, selimije, tërbeshk dhe arna e kuqe. Më e rëndësishmja nga të gjitha ishte anteria e mirë, pasi ajo vishej ditën e martesës, nëpër dasma, festa, vizita. Materiali ishte i mëndafshhtë me ngjyrë të kuqe dhe me vija të ngushta të bardha. Kishte krahë të gjatë dhe përbëhej prej dhjetë kindave, në të dy anët nga pesë. Ajo nuk mbërthehej por rrinte e hapur me qëllim që të dukej xhybeli dhe këmisha. Është e punuar me serm dhe gajtan dhe në pjesën e përparme tek jaka ka disa pulla nga sermi. Pjesët e kindave janë të mbuluara me shirita sermi, me qëllim që të mos duket e qepura mes kindave. Anteritë e tjera vijnë pas anterisë së mirë dhe

janë më pak të qëndisura. Ato vishen nga vajzat, nusët dhe gratë e reja.



Fig. 3 Anteria e mirë: a □ Para dhe b □ mbrapa



Fig. 4. Brezi



Fig. 5. Poshi

(4) Duhet të theksohet se kemi edhe **brezin** prej leshi të përgatitur vetë. Brezi (fig. 4) mbahet nga të gjitha grup moshat, nusët, vajzat dhe gratë e reja, i përgatisin me shumë ngjyra të hapura, ndërsa gratë e moshuara i përdorin ngjyrat më të errëta. Brezi shfrytëzohet për të shtrënguar anterinë, këmishën dhe xhybelin, si dhe si mbrojtëse e mesit.

(5) Përveç brezit kemi edhe poshin (fig. 5), që është e njëjtë me brezin. (shtë i punuar prej

materialit të mëndafshhtë dhe shfrytëzohet si zbukurim nga nuset dhe gratë e reja.



Fig. 6. Bofçarkat

(6) Një pjesë tjetër e rëndësishme e veshjes është **bofçarka** (fig. 6), që ndryshe quhet edhe **skutaçe**. Është pjesë e pandashme e veshjes tradicionale dhe vishet nga të gjitha grup moshat. Zbukurimet e bofçarkave bëhen sipas dëshirës, vajzat dhe gratë e veja i zbukurojnë më pak dhe me motive më të thjeshta, ndërsa nuset dhe gratë e reja me motive të ndryshme gjeometrike, floriale, bimore, shtazore. Përveç kësaj përdoren sermi, roza, para të argjendta dhe të bakrit, ojat e ndryshme për zbukurim. Plakat më së shumti veshin bofçarka të kuqe me viza të zeza ose të bardha dhe, me simetri janë më të mëdha dhe shumë të thjeshta për nga prerja.



Fig. 7. Kalçinjët

(7) Nga pjesët e tjera të veshjes do të përmendim edhe **tërlikun** ose **xharin**, siç emërtohet në

fshatin Sallarevë. Përgatitet nga materiale industriale, më parë është qepur nga një lloj pambuku i trashë, ndërsa sot prej satenit ose mëndafshit të zi. Qepet nga vetë gratë sipas masës trupore dhe me krahë të gjatë. Tërliku vishet nga plakat dhe vajzat gjatë gjithë kohës mbi këmbët e bardhë, ndërsa nga nuset dhe gratë e reja vishet mbi anteritë, kur dalin jashtë shtëpisë, si mbulesë e veshjes së mirë.

Siç shohim nga më sipër, gjithmonë është vërejtur dhe dalluar veshja sipas grup moshave, rasteve, gjendjes ekonomike si dhe statusit në shoqëri. Sot nëpër këto fshatra veshja tradicionale zakonisht përdoret nëpër dasma dhe festime të ndryshme nga shumica e grave të reja dhe vajzave, derisa nga gratë e moshuara ajo është veshja e vetme e cila vishet. P.sh., në fshatin Gurgurnicë 40% e grave mbi 40 vjeç mbajnë veshje tradicionale, ndërsa nën 40 vjet vetëm 10%. Në fshatin Sallarevë mbi 50% e grave 40 vjeç e sipër mbajnë veshje tradicionale, ndërsa 70% e grave preferojnë këtë veshje nëpër dasma dhe festa të ndryshme. Veshja tradicionale deri para disa viteve është veshur nga shumica e vajzave edhe ditën e martesës, ajo edhe sot preferohet vetëm nëse vajzat martohen brenda fshatit ose në martesat me fshatrat Koritë dhe Gurgurnicë.



Fig. 8. Veshja e malit të Thatë; a □ para dhe b □ prapa

PËRFUNDIM

Njerëzit në këtë rajon me shekuj janë munduar që sa më mirë dhe sa më shumë ti zbukurojnë veshjet. Ata, zakonisht, veshjet i kanë prodhuar në kushtet shtëpiake dhe janë munduar të krijojnë forma dhe motive më të bukura ose më të gjalla dhe t'i qëndisin ato, pra, shpesh është përdorur fantazia dhe shkathtësia e femrave në qëndisje. Veshjet tradicionale shqiptare janë të shumëllojshme, me elemente të ndryshme, nga të cilat disa e kanë zanafillën që nga koha e vjetër, nga kultura ilire. Në kohërat e sotme zbukurimi, shumëllojshmëria e veshjeve dhe elementet e ndryshme ende ekzistojnë, por bartësit e tyre janë të paktë. Në 20-30 vjetët e fundit filloi me të madhe të pakësohet numri i atyre që përdornin veshje tradicionale. Megjithëse në fshatrat e Malit të Thatë akoma ka banorë që mbajnë veshje tradicionale në raste festash të ndryshme dhe dasmash, pse jo si më parë. Për dallim nga zona e Malit të thatë, ka shumë rajone ku veshjet tradicionale janë zhdukur krejtësisht, duke mbetur në kujtesën e më të moshuarve kujtimet rreth veshjes që dikur në moshë më të re vetë i kishin bartur ose si fëmijë i kishin hasur tek të tjerët.

BIBLIOGRAFIA

- BRINGEMEIER, Martha (1985), *Mode und Tracht*, Münster.
- BRÜCKNER, Wolfgang (1987), *Mode und Tracht: Olaf Bockhorn / Beitz Klaus: Kleidung-Mode-Tracht*, Wien: 15 - 43.
- GJERGJI, Andromaqi (2004), *Albanian Costumes Through the Centuries, Origin, Types, Evolution*, Tirana.
- GJERGJI, Andromaqi (1998), *Die Volkstrachten*. In: Werner Daum: *Albanien zwischen Kreuz und Halbmond*, München: 179 – 197.
- GJERGJI, Andromaqi (1983), Përparëset në veshjet popullore shqiptare: *Etnografia Shqiptare* 13, Tiranë: 51 – 74.
- GJERGJI, Andromaqi (1981), Veshjet popullore. Këmisha e grave: *Etnografia Shqiptare* 11, Tiranë: 23 – 68.
- HALIMI – STATOVCI, Drita (2009), *Veshjet shqiptare të Kosovës*, Prishtinë.
- NOPCSA, Franz Baron (1925), *Albanien-Bauten, Trachten und Geräte Nordalbaniens*. Berlin / Leipzig.
- PERRONE, Lluka (1983), Të veshurat e grave – Ejaninë (Kalabri): *Etnografia Shqiptare* 13, Tiranë: 43 – 50 .